


2



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U**  
**PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA**

Nr.regj. 24891/11

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Qazim Hysenaj nga Qagllavica, për kundërvajtje nga neni **6 par. 1 dhe 2 e sanksionuar sipas 16 paragrafi 1.2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151**, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.1 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 09.12.2011 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Qazim Hysen Hysenaj , më vendbanim në Qagllavicë lagj. Nici, për kundërvajtje nga neni **6 par. 1 dhe 2 e sanksionuar sipas 16 paragrafi 1.2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151**.

Pezullimi behet konforme neni 198 al.1 te LMK-ës se fjalë për veprim qe nuk është përcaktuar si kundërvajtje.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesë


**A r s y e t i m**

Agjensia Kundër Korrupsionit , parashtrroi kërkesën nr.01. 3227/11 të dt 19.07.2011 për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartpërmendurit e për kundërvajtjen e lartcekur.

Ne baze te kërkesës u degjua deklarata e të lartcekurit i cili deklaroi se unë e kam marrë detyrën e ushtruesit te detyrës se drejtorit te ORL dhe ketë me afat deri sa te shpallet konkursi e qe konkursi është shpall menjëherë pas marrjes se detyrës sime, por i njëjti konkurs është anuluar qe 3 herë ashtu qe unë ende nuk jam i zgjedhur në këtë post. Nuk kam qenë i informuar as nga agjensioni kundër korrupsion se jam i obliguar ta paraqes prejardhjen e pasurisë as nga Ministria, se nuk e di se kush është kompetent qe te na njoftoj dhe ti sjell fermullaret e gjanesionit ani korrupsion, dhe mua sa kush nuk mi ka sjell se atë detyrim do ta kisha deklaruar menjëherë dhe pa hezitim dhe nuk kam ndonjë arsye qe mos ta deklaroi pasurin time, ku unë për herë të parë jam njoftuar se duhet ta lajmëroj pasurin kur e kam marrë ftesën e juaj, nuk e pranoj kundërvajtjen qe me vihet për arsye se unë nuk ka qenë i informuar as nga agjensioni në çoft se për mes ftesës apo nga Ministria e Shëndetësisë dhe për këtë arsye nuk e ndi veten përgjegjës.

Sipas kërkesës se ushtruar marrjes ne pyetje te pandehurin dhe prova te tjera te administruar ne lëndë , gjyqtari, konform 3 lidhur me përkufizimin zyrtarëve te lartë publik nuk ishte e parapara kategori e ushtrueseve te detyrës qe te njëjtit te obliguar ta paraqesin pasurin e tyre te parapara sipas keti Ligji, andaj konform neni 198 al.1 te LMK-së e PEZULLOI procedurën kundërvajtëse ndaj te lartpërmendurit . se fjalë për veprim qe nuk është përcaktuar si kundërvajtje.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër ketij aktvendimi ankesë mund të ushtroj pala dhe ushtruesi i kërkesës Gjykatës se larte për kundërvajtje ne Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj Gjykate pa taksa.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dap. <u>DP</u>	Nr. Prot Br Prot Prot No <u>03-5155/11</u>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <u>01</u>	Data Datum Date <u>30.12.2011</u>
PRISHTINE	